




REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	1-180/4633
Nr. ifaq.	5
Data	31/05/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. Prot.01/01

Dt. 31.05.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 5 dhe 22 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndardjes së Subvencioneve, Rregullores MF – Nr. 04/2017 për Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, Kryetari i Komunës hapë:

THIRRJE PUBLIKE

Për të gjithë organizatat joqeveritare dhe Institucionet e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe individë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe që zhvillojnë aktivitete për qytetaret e Komunës së Junik dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, të aplikojnë përmes mbështetje financiare.

1. SEKTORI I KULTURËS

OJQ-të, Institucionet Kulturore dhe individët në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore si më poshtë:

Art vizual – figurativ: krijim i veprës së re, fuqizim i artistëve të rinj, ekspozitë, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

Krijimtari letrare: krijim i veprës së re, promovimi i veprave letrare, organizimi i orëve letrare;

Festival: art në hapësira publike, shumë disiplinor, muzikë, folklor , vallëzim etj.;

Manifestime: shënim i datave historike, shënim i festave kombëtare dhe ndërkontinentale dhe shënim i datave të tjera me rëndësi në Komunën e Junik;

Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave kulturore: aktivitete mujore, fuqizim i krijuesve të rinj, debate, ligjérata dhe hulumtime;

Muzikë: Koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

Shoqëri kulturore-artistike: mbështetje të aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festival;

Trashëgimi kulturore: fushata vetëdijesimi, pjesëmarrje në aktivitete përmes mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim, promovim i diversitetit kulturor, turizëm kulturor, platforma informative;

2. SEKTORI I RINISË

OJQ-të, Institucionet Rinore dhe individë në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt propozimet për organizimin e aktiviteteve rinore si më poshtë:

Pjesëmarrje të rinisë: Fushata senzibilizuese, promovim i mekanizmave ligjor për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje, promovim i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare, fuqizim të qytetarisë aktive, mobilizim për aktivitetet rinore, tryeza diskutimi (debate), seminare, punëtori, kampe dhe hulumtime;

Edukim Joformal: Aktivitete zhvilluese personale dhe sociale që iu ofrohen të rinde dëshmojnë të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet të nevojshme për tregun e punës, aktivitete për ngritjen e shkathtësive e të folurit publik, edukim financiar, lidership dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme që përfshijnë komunitetin, organizim të panaireve për promovim të OJQ-ve si dhe informim i të rinde për kyçje në tregun e punës

Mjedisë i shëndetshëm dhe i sigurte për të rindjtë: Fushata vetëdijesuake, promovim të edukimit shëndetësor, ligjëratë, vizita studimore, hulumtime që cenojnë mjedisin e sigurte të të rinde,

Kulturë, Sport dhe Rekreacion: Organizimin e aktiviteteve tradicionale për të rindjtë (Muaji i rinisë, Dita Ndërkontinentale e Rinisë), koncerthe rinore, fuqizim i muzikantëve të rindë, programe kulturore, aktivitete kreative (art figurative, art në hapësira publike, arkitekturë, skulpturë), gara sportive, aktivitete rekreative (ecje, ngjitje) etj.

3. SEKTORI I SPORTIT

Në këtë thirrje hyjnë të gjitha klubet sportive të regjistruara dhe sportistet e dalluar ne sektorin e sportit në komunën e Junikut.

KRITERET PËR PJESËMARRJE NË THIRRJEN PUBLIKE PËR SUBVENCION

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, Klubet sportive të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike;
- Individ me vendbanim në komunën e Junikut dhe realizojnë aktivitetin e tij/saj në komunën e Junikut;
- Individët, Klubet Sportive, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën për të cilën aplikojnë në Kulturë, në Rini apo në Sport;
- Institucionet, Individët, Klubet sportive, OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Junikut dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Junikut dhe jashtë sajë;
- Individët, Klubet sportive, OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Junikut.
- Individët, Klubet sportive, OJQ-të të cilët nuk kanë përmbylli rapportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Junikut në këtë thirrje;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete brenda të njëjtit vit fiskal,

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interes i në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Individët, Klubet Sportive, OJQ-të, nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Junikut brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme;
- Nuk subvencionohen qiraja për zyre, inventari, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që mund të kenë ndikim politik, religjioz, etj;
- Nuk subvencionohen sportistët individualisht të cilët janë të organizuar brenda klubeve të cilat subvencionohen;
- Klubet Sportive nuk mbështeten me kërkesën e derivateve gjatë vitit por duhet të planifikuar në programin e punës – vijën buxhetore;
- Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Junikut,
- Nuk mbështeten programet dhe aktivitete e përfunduara;
- Nuk mbështeten librat e publikuara(shtypura);
- Nuk mbështeten finansiarisht aktivitet që do të realizohen përmes internetit (Online), mbështeten vetëm në formë logjistike, dhe asistencë teknike;
- Përparësi të mbështetjes financiare kanë projektet inovative dhe tradicionale, promovuese në arenën ndërkombëtare.

Projekt Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Aplikacioni për Aplikantët dorëzohen në kopje fizike përmes protokollit të komunës.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mylljes së thirrjes publike. Shkarkimi nga faqja e internetit i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.

Përfituesi i subvencionit nga Komuna para nënshkrimit te kontratës eshtë i obliguar ta sjell Formularin 4 (Shpenzimet e parapara nga buxheti i ndarë nga Sektori) ta paraqet linjën buxhetore të shumës së subvencionuar në zyrën e financave.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregulloren për subvencione.

Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në OJQ, apo cilido variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjtë vlen edhe për ndryshim të xhirologarisë. Të gjithë aplikantët të cilët janë të regjistruar në sistem dhe kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Më shumë informacione dhe materiale të nevojshme lidhur me procesin e ndarjes subvencioneve mund ti merrni në zyrat DAKRS.

Monitorimi:

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ta bëjë monitorimin sipas kalendarit të paraparë nga OJQ-të, Klubet dhe Institucionet.

1. Përfaqësuesi i Sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sport (për OJQ-të dhe Institucionet e Kulturës, Rinisë dhe sport),
2. Zyrتari monitorues i DAKRS-së,
3. Zyrتari nga Financat.

Mbështetja Financiare:

Vlera e përgjithshme e planifikuar e thirrjes 4,000.00(euro). Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të aplikohet për çdo projekt individual është 200.00(euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 500.00 (euro), ndërsa shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të është 600.00 euro dhe maksimale 1,000.00 euro.

MËNYRA E APLIKIMIT

Institucionet, OJQ-të duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Kopjen e letërnjoftimit të drejtuesit të OJQ-ës ose institucionit apo dokument tjetër identifikues i vlefshëm;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimin/Konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Vërtetimin që OJQ, Institucioni nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Adresën e OJQ-së (selia);
- Projekt propozimin së bashku me Aplikacionet (Të dhënat e organizatës dhe Projekt propozimi si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme Formularët nga 1-7);
- Dëshmi nga ATK që organizata është aktive

Klubet Sportive duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Klubit);
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimin që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Vendimin e regjistrimit të klubit
- Projekt propozimin së bashku me Aplikacionet (Të dhënat e organizatës dhe Projekt propozimi si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme Formularët nga 1-7);

Aplikuesit individual duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Kopjen e letërnjoftimit apo dokument tjetër identifikues e vlefshëm;
- Certifikatën e vendbanimit;
- Projekt propozimin si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme Formularët nga 1-7;
- Vërtetimin/Konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse;
- Dëshmja që individi nuk është nën hetime;

Formularët për aplikim mund të merren në zyrën pritëse , në katin e parë në objektin komunal ose mund të shkarkohet përmes faqes zyrtare të komunës <https://kk.rks-gov.net/junik/>.

Pasi ti plotësoni dokumentacionet i futni në zarf të mbyllur dhe e dorëzoni në sportelet e administratës ku bëhet protokollimi i lëndës.

Afati për aplikim është nga data **03.06.2024** deri me **21.06.2024** në ora **16:00**.

Periudha e zbatimit të projektit është deri **në fund të muajit dhjetor 2024**.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën:
Klodiana.pepshi@rks-gov.net

